

ISLAM RUSI


(1912 - 1980)

PINGULI R.

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Natyrore, Departamenti i Kimisë Industriale

Islam Rusi, i takon atij brezi kimistësh që i kanë shërbyer me përkushtim shembullor interesave të vendit, shkencës, arsimit dhe të kulturës shqiptare, duke zënë vend të veçantë në altarin e shkencëtarëve, pedagogëve dhe shkencëtarëve në prodhim, veçanërisht në fushën e kimisë së zbatuar industriale dhe ushqimore.

Islam Pertef Rusi lindi në Leskovik të Kolonjës më 11 Dhjetor 1912 në një familje me tradita të shquara atdhetare. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa studimet e mesme në Liceun Francez të Korçës. Në vitin 1933 regjistrohet në një nga universitetet më të vjetra dhe më të dëgjura të Evropës, në Universitetin e Padovës, Itali. Studimet i përfundoi me sukses të plotë në vitin 1938 duke u diplomuar si kimist dhe farmacist. Në vitin 1940, filloi punën si kimist i thjeshtë në laboratorin kimik pranë Ministrisë së Ekonomisë në Tiranë. Pas Çlirimit të vendit ai punoi në laboratorin e trashëguar, të cilin e shndërroi në të vetmin Laborator Qendror Kimik të pajisur më mirë dhe me një bërthamë kuadrosh kimistë të aftë e të përkushtuar. Ky laborator luajti rol të rëndësishëm në forcimin e kontrollit dhe në përmirësimin e cilësisë së produkteve në shkallë vendi. Në fillim të vitit 1962, mbi themelin e këtij laborator, me nismën dhe punën e madhe e të apasionuar të Islam Rusit, krijohet Instituti i Kërkimeve Industriale, pararendësi i Institutit të sotëm të Kërkimeve të Ushqimit dhe i disa Instituteve të tjera të sistemit të industrisë e të mineraleve. Atij i takoi dhe nderi i merituar që të bëhej i pari drejtor i këtij instituti që *defakto* mbeti i tillë deri sa doli në pension edhe pse *dejure*, për një kohë ai njihej si zv. drejtor.



Veprimtaria mbi 30-vjeçare shkencore, pedagogjike dhe prodhuese e Prof. Islamit është e gjerë, e larmishme dhe dobiprurëse. Ai punoi në tri drejtime kryesore:

Së pari, si organizator dhe drejtues kryesor administrativ e shkencor i Institutit, kryetar i këshillit drejtues të tij, anëtar i këshillit shkencor të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, anëtar i Kolegjumit të Ministrisë së Industrisë, ideator dhe bashkëpunëtor i Buletinit 'Përmbledhje Studimesh', anëtar i kolegjumit të revistës 'Teknika', organ i Ministrisë së Industrisë, kryetar 'nderi' i konkurseve kombëtare të degustimit të verërave, kryetar i komisionit të Mbrojtjes së Diplomave në Fakultetin e Shkencave të Natyrës për degën e Kimisë etj.

Së dyti, si ideator, drejtues, apo bashkëautor i shumë temave studimore të kryera në Institut ose në shkallë kombëtare, në fusha nga më të ndryshmet si: pastrimi i rërave të Devollit për përdorim në industrinë e qelqit; prodhimi i karbitit në vend; prodhimi i çimentos së bardhë; zbutja e ujit industrial për industrinë e tekstilit; prodhimi i karbonit aktiv; projektimi i kriporës së Vlorës, si edhe pastrimi i kripës së gurit të Dhrovjanit nga argjila për industrinë e sodës; përdorimi i rërave kuarcore të Priskës e të Shishtavecit për fonderitë; studimi i përbërjes së tokave, duke dhënë një ndihmesë shumë të madhe shkencore dhe praktike për zgjedhjen e metodave analitike dhe në ngritjen e laboratorëve analitikë në shumë rrethe të vendit.

Islam Rusi njihet dhe vlerësohet si njëri prej pionerëve të Kimisë Analitike, teorike e të zbatuar, si themelues i katedrës së Kimisë Analitike dhe pedagog i kësaj lënde. Formimi i tij si kimist analist me këndvështrim të gjerë në pothuajse të gjithë fushat e industrisë e të mineraleve dhe në të njëjtën kohë me një përgatitje teorike të lartë, bëri që të fitonte autoritet dhe respekt të padiskutueshëm jo vetëm midis studentëve të tij, por edhe tek kimistët e vjetër e të rinj. Profesor Islami ishte një ndër hartuesit dhe stabilizuesit e parë të metodikave analitike për analizat e mineraleve e të produkteve industriale. Ndhimesë të çmuar ka dhënë ai edhe në përgatitjen e kualifikimin e kuadrove të rinj të sektorit analitik. Falë njohurive të tij të gjera e të thella dhe të vetëmohimit në punë, profesor Rusi ka dhënë ndihmesë të gjithanëshme, gjithashtu, edhe në kontrollin dhe stabilizimin e proceseve teknologjike, jo vetëm si konsulent i përhershëm i institucioneve qendrore dhe ndërmarrjeve të prodhimit, por edhe si pjesëmarrës aktiv në zgjidhjen e problemeve sa të shumta aq edhe të ndërlikuara që nxirrte zhvillimi dhe ecuria e industrisë sonë.

Për këtë punë të gjatë e shumë të dobishme, Islam Rusi do të kujtohet me nderime si shkencëtar i mirëfilltë dhe pedagog i apasionuar, si organizues e drejtues i aftë, kërkues rigoroz, si koleg i respektuar e shumë komunikues, shok i dashur dhe familjar shembullor.